

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 69/2022

**PËR NDRYSHIMIN E RENDIT TË DITËS TË SEANCËS PLENARE
DATË 15.9.2022**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 31 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Miratimin e ndryshimit të rendit të ditës të seancës plenare të datës 15.9.2022 si më poshtë:

I. Hiqen nga rendi i ditës i seancës plenare të datës 15.9.2022 pikat 6 dhe 7:

“Projektvendim “Për zgjedhjen e z. Albert Minga anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar”.

Projektvendim “Për zgjedhjen e z. Edmond Tullumani anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar”.”.

II. Shtohet si pikë e rendit të ditës të seancës plenare të datës 15.9.2022 projektvendimi “Për zgjedhjen e z. Florian Bjanku anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën 15.9.2022